



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 76
Prishtinë, më 13 shtator 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 13 SHTATOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Sabri HAMITI**.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 58 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Ai procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albana Gashi, Goran Marinković, Bekim Haxhiu, Hashim Deshishku, Vesna Mikiq, Berat Buzhala, Ismet Beqiri, Blerta Deliu-Kodra dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se kur dhe si e ka përmendur çështjen e Luginës së Preshevës në bisedimet me Serbinë në Bruksel dhe cili është rezultati.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje atë se a është në dijeni dhe çfarë është ndërmarrë për ta penguar një financim nga Rusia në Kosovë, i cili i referohet pikës 32 të kapitullit VII - Trashëgimia kulturore dhe fetare, të Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Mun, për anëtarët e KS të OKB-së.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila në lidhje me atë se sa është përqindja e tregut që e ka tani kompania “Titan” si pasojë e mbrojtjes nga Qeveria, dhe sa kanë rënë importet nga Shqipëria, si pasojë e masës së vendosur nga ajo.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila nuk ishte e pranishme.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila në lidhje me atë se sa milionë euro ka qenë profiti i kompanisë “Titan” gjatë kohës sa ka qenë në fuqi masa mbrojtëse për importin e çimentos prej 35 %.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila nuk ishte e pranishme.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me masat e ndërmarra nga ministria që ai e drejton për përmirësimin e gjendjes së trotuareve, sinjalizimit, shpejtësisë së kufizuar, vendosjen e pengesave të ashtuquajtura “policë të shtrirë”, posaçërisht në afërsi të shkollave.

Ministri Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 6 dhe 7 shtator 2012,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartimore,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 6 dhe 7 shtator 2012

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 6 dhe 7 shtator 2012.

Deputeti Arsim Bajrami dha sqarime lidhur me çështjet që i kishte ngrëhur ngritur deputeti Rasim Demiri, në mbledhjen plenare të datës 7 shtator 2012, lidhur me ndryshimet kushtetuese. Sqarimi i plotë i deputetit Arsim Bajrami është dhënë në transkript.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartimore

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për procedurën përmbartimore.

Ministri **Hajredin Kuçi** tha se ky projektligj rregullon: mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të procedurës përmbartimore në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare, bazën ligjore për funksionimin e përmbartuesve privatë, përfshirë kriteret që duhet t'i përmbushin shtetasit për ushtrimin e detyrës së përmbartuesit privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, tarifat, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet tjera publike dhe private.

Në vazhdim, ai theksoi se projektligji e rregullon edhe procedurën e emërimit, licencimit, regjistrimit, çregjistrimit, disiplinimit, largimit, si dhe shkarkimit të përmbartuesve privatë.

Më pas, ministri sqaroi se çështjet më të rëndësishme që i adreson ky projektligj janë: zbatimi më cilësor i procedurave dhe ekzekutimi më efikas i sistemit të procedurës përmbartimore në nivelin shtetëror, në mënyrë që të mundësojë përfundimin e pjesës më të madhe të volumit të punëve me resurse të kufizuara në kuptimin e burimeve njerëzore, të kohës dhe mjeteve financiare.

Ministri më tutje u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe elaboroi përmbajtjen e pjesëve të tij, si dhe në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të projektligjit.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për procedurën përmbartimore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzan Novobërdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për procedurën përmbartimore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për procedurën përmbartimore.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës..

Ministri **Dardan Gashi** tha se ky projektligj e rregullon themelimin, misionin, organizimin, funksionin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Në vazhdim, ai tha se kjo agjenci do të merret me realizmin e ndërtimit dhe menaxhimin e komplekseve memoriale, duke u mbështetur në Ligjin nr. 03/L-106 për planifikim hapësinor dhe ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, neni 10 dhe 12 i këtij ligji.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Njazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Afërdita Berisha-Shaqiri- në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Arben Gashi, Hykmete Bajrami, Bekim Haxhiu, Lirije Kajtazi, Haki Demolli, Gëzim Kelmendi, Halit Krasniqi, Teuta Haxhiu, Hydajet Hyseni, Myzejene Selmani dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Ministri **Dardan Gashi** tha se ky projektligj rregullon qasjen në informata që lidhen me ujërat, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes që ka të bëjë me menaxhimin e ujërave, vlerësimin e ndikimit nga strategjitë e ndryshme, planet dhe programet mbi mjedisin, pengimin dhe kontrollin e avarive me praninë e materieve të rrezikshme, lejet e integruara ekologjike për punë dhe instalime që ndikojnë në mjedisin ujor.

Në vazhdim, ai tha se pasi në Ligjin nr. 2004/24 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2004/41 nuk mbulohet në tërësi fusha e administrimit të resurseve ujore, në të cilën nuk janë përfshirë detyrimet që dalin nga direktiva e BE-së 2000/60/EC, këto edhe janë arsye kryesore, të cilat kanë ndikuar në hartimin e këtij projektligji.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ujërat e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Njazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Salih Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision FunkSIONal dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONal Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Raportin e Komisionit FunkSIONal për Legjislacion e paraqiti deputeti Arben Gashi, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pasi në këtë projektligj nuk ishte propozuar asnjë amendament, atëherë kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për bujqësinë organike.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe amendamentin nr. 3.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin për bujqësinë organike.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin Rural

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

* * *

Kryesuesi i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale